



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE

___/___/2015

Nr. _____ Prot.

RELACION

Mbi

Hapjen e ankandit publik te Lokaleve ne katin perdhe te Baneses 83/5 Kavaje

Pershkrimi

Ne qytetin e Kavajës është ndërtuar me fondet e EKB-së një banesë Tip 83/5, 8 kate me 35 apartamente dhe një kat lokale shërbimi në katin përdhe.

Objekti është ndërtuar në zonën e Ish Rezervave të Shtetit, Kavajë, në një zonë e cila është e formuluar me ndërtime të reja, në një pozicion shumë të favorshëm në raport me rrugën.

Ekzistenca e Lokaleve në katin përdhe ka përcaktuar vijën e ndërtimit dhe e ka bërë më urbane dhe me njerëzore pjesën e rrugës duke i dhënë kësaj një dimension tregëtar që është mjaft i nevojshëm për zonën.

Arkitektura e objektit Banesë tip 83/5 8 kate është e thjeshtë, një arkitekture banimi me një fasadë me suva dhe bojë plastike. Banesa është e paisur me ashensor.

Kati përdhe është një kat me 6 njësi shërbimi, për të cilin, punimet e rifinitures si shtresa, suvatime e bojatisje, dyer e dritare janë kryer me cilesi.

Dyshemeja e katit përdhe është e hidroizoluar me dy shtresa guajn dhe e shtruar me pllaka qeramike cilesi e pare.

Eshte realizuar rrjeti rrufeprites, togezimi eshte bere me hekur L50*50*5mm

Për katin përdhe lokal shërbimi janë realizuar hyrjet e daljet me rampa te veçanta .

Shkallët janë veshur me pllaka mermeri.

Objekti ka këto kondicione urbane:

- √ Lartesia e pergjithshme e godines eshte 28.34 meter
- Numri i kateve 8,
- √ Distanca e volumit nga aksi i rruges eshte 15 m
- √ Distanca e volumit nga Trotuari eshte 8 m
- √ Siperfaqe e ndertimit (Truall+ Trotuar) eshte 416 m2
- √ Nr.i lokaleve eshte 6
- √ Hyrja kryesore nga rruga

Ambjenti perreth objektit deri ne lidhjen me trotuarin e rruges eshte i sistemuar

Objekti eshte i lidhur me infrastrukturen inxhinierike FU, FEE, KUZ.

Hyrjet e sherbimeve të katit perdhe jane nga jugu dhe veriu.

Te dhenat mbi siperfaqen e lokaleve ne katin perdhe

Kati perdhe ka nje siperfaqe ne total 378.0 m2

Pershkrimi i katit perdhe sipas faktit

Siperfaqe totale e katit perdhe 378.0 m2

- √ Siperfaqja totale 343.77 m2
- √ Pjesa e perbashket me banesen me sip. 34.23 m2

Siperfaqet sipas lokaleve

Lokali	Sip.shfrytezimi m2	
Njesia 2	71,55	
Njesia 3	41,47	
Njesia 4	77,44	
Totali i sip.te lokaleve ne k.perdhe		343,77

Me Vendim te Keshillit Drejtues te EKB-se Nr 58, date 27/11/2014 eshte miratuar çmimi dysheme i hapjes se ankandit publik, per te realizuar shitjen e lokaleve ne katin perdhe ne vleren **53.000 (pesedhjete e tre mije)leke / m2**, per njesite 2,3dhe 4 dhe **56.000 (pesedhjete e gjashte mije) leke / m2** per njesite 1,5 dhe 6

Bashkelidhur ketij informacioni do gjeni:

1-Planimetrine e sheshit te ndertimit

2- Planimetria e katit perdhe lokal sherbimi.

Shkalla 1: 200

3- Kopje te çertifikatave te pronesise

4- Kopje te Vendimit te Keshillit Drejtues te EKB Nr 58, date 27/11/2014

Dokumentacioni i mesiperm sherben per hapjen e ankandit publik te shitjes se Lokaleve ne katin perdhe te baneses tip 83/5, 8 kate me 35 apartamente dhe nje kat lokale sherbimi te ndertuar me fondet e EKB-se ne qytetin e Kavajes.

Drejtoria Teknike